VENDIM
Nr. 188, datë 25.3.2021

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE BUXHETORE, NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve buxhetore, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 05320 "Për mbrojtjen e mjedisit", shpenzimet korrente pakësohen në vlerën 17 063 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë;

b) Në programin buxhetor 04760 "Zhvillimi i turizmit", shpenzimet korrente shtohen në vlerën 17 063 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe